

LIGJ
Nr.7599, datë 2.9.1992

KODI DOGANOR I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

PJESA E PARË
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

KREU I
FUNKSIONET DHE ORGANIZIMI I DOGANAVE

Neni 1

Qëllimi i veprimtarisë doganore

Veprimtaria doganore siguron, në të gjithë territorin doganor, mbrojtjen e interesave të Republikës së Shqipërisë, që lidhen me importin, eksportin dhe tranzitin, me kalimin e kufirit dhe me qarkullimin e mallrave, me dërgesat postare ndërkombëtare dhe me personat fizikë dhe bagazhet e tyre.

Neni 2

Territori doganor

1. Territori doganor përfshin territorin tokësor, ujrat territoriale dhe hapësirën ajrore të Republikës së Shqipërisë.

2. Në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë mund të organizohen zona të lira që i nënshtrohen një regjimi të veçantë doganor, të përcaktuar me dispozita ligjore.

3. Ministri i Financave dhe Ekonomisë, ka të drejtë të caktojë zonat doganore, që i nënshtrohen një regjimi të veçantë pune.

Neni 3

Organet doganore

Me organe doganore, për efekt të zbatimit të këtij kodi, sipas rastit kuptohet: Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, drejtorët e drejtorive rajonale, kryetarët e zyrave doganore dhe doganierët.

Neni 4

Zbatimi i legjislacionit doganor

Kodi doganor dhe dispozitat nënligjore, që dalin në bazë e për zbatim të tij zbatohen në të gjithë territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

Neni 5

Drejtimi, organizimi dhe kontrolli i veprimtarisë doganore

Në Republikën e Shqipërisë drejtimin, organizimin dhe kontrollin e veprimtarisë doganore e kryen Drejtoria e Përgjithshme e Doganave. Drejtori i Përgjithshëm i Doganave vepron nën vartësinë e ministrit të Financave dhe të Ekonomisë.

Neni 6

Zonat doganore dhe vendosja e tyre

Zonat doganore vendosen në kufijtë shtetërorë dhe në pikat e tjera të territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.

Krijimi, shtrirja territoriale dhe klasifikimi i zonave doganore të përhershme ose të përkohshme caktohen nga ministri i Financave dhe i Ekonomisë.

Neni 7

Detyrimet e doganierit

1. Për zbatimin e dispozitave të këtij kodi, doganierët veprojnë me paraqitjen e mallrave, të mjeteve të transportit dhe të personave në doganë, në të gjithë territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

2. Doganierët zbatojnë dispozitat e këtij kodi dhe aktet nënligjore që dalin, në bazë e për zbatim të tij. Ata gëzojnë të drejtat dhe detyrat në bazë të këtij kodi, për sa kohë që janë në marrëdhënie pune në organet doganore.

3. Doganierët gjatë përmbushjes së detyrës kanë të drejtë të mbajnë e të përdorin armë në përputhje me dispozitat përkatëse. Ata veprojnë me uniformë. Kur veprojnë pa uniformë, detyrohen të paraqesin dokumentin identifikues, me të cilin janë pajisur.

4. Doganierëve u ndalohet të pranojnë drejtpërdrejt a tërthorazi çdo shpërblim ose dhuratë, gjatë apo për veprimet që lidhen me detyrën e tyre si doganierë.

5. Doganierëve u ndalohet të ushtrojnë çdo lloj veprimtarie tregtare private.

6. Doganierët ruajnë sekretet profesionale për të gjitha çështjet që lidhen me veprimtarinë e tyre zyrtare.

Neni 8

Caktimi në detyrën e doganierit

1. Në detyrën e doganierit mund të caktohen shtetasit shqiptarë, që kanë arsimin përkatës në përputhje me kriteret e vendosura nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe kanë figurë të pastër morale.

2. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave cakton detyrat e doganierit, bën regjistrimin nga librat përkatës dhe i pajis ata me librezën e doganierit.

Neni 9

Detyrat e organeve doganore

Organet Doganore të Republikës së Shqipërisë kanë këto detyra:

1. Kontrollojnë mallrat e importuara e të eksportuara, mallrat e tranzituara, mjetet e transportit ujor, tokësor e ajror, dërgesat postare ndërkombëtare, personat fizikë që hyjnë e dalin nga territori i Republikës së Shqipërisë dhe bagazhet e tyre për të verifikuar ligjshmërinë e kalimit të tyre në kufi dhe gjendjen e mallrave, personave dhe mjeteve të transportit, sipas dispozitave ligjore dhe rregullave që organet doganore janë ngarkuar të zbatojnë.

2. Kontrollojnë vlerat valutore dhe sendet e tjera me vlerë që hyjnë e dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë.

3. Marrin masa për parandalimin e zbulimin e kontrabandës, si dhe shkeljeve të dispozitave që kanë lidhje me veprimtarinë doganore.

4. Llogaritin dhe arkëtojnë taksat doganore.

5. Ngrenë dhe ndjekin pranë gjykatave paditë për çështjet që i përkasin veprimtarisë doganore.

6. Marrin pjesë në hartimin e projekt marrëveshjeve e të projektkonventave ndërkombëtare për çështjet doganore.

7. Organizojnë dhe mbajnë statistikën e tregtisë së jashtme sipas dokumentacionit të miratuar nga Ministria e Financave dhe e Ekonomisë dhe Ministria e Tregtisë dhe e Lidhjeve Ekonomike me

Jashtë.

8. Caktojnë llojin dhe kriteret për pajisjen me uniformë të punonjësve të doganave.

9. Hartojnë e zbatojnë planet ekonomiko-financiare të të ardhurave e shpenzimeve të organeve doganore.

Neni 10

Ndalimi i importit, eksportimit dhe tranzitimit për mallra të veçanta

Ministri i Financave dhe i Ekonomisë në bashkëpunim me ministrat përkatës përcaktojnë mallrat, që ndalohen të hyjnë a të dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, ose këto mallra ia nënshtrojnë një regjimi të veçantë importimi, eksportimi e tranzitimi, për arsye të ruajtjes së rendit publik, sigurisë shoqërore, mbrojtjes së shëndetit e jetës së njerëzve, kafshëve e bimëve, mbrojtjes së pasurisë kombëtare e të mallrave që kanë vlera shkencore, artistike, historike, arkeologjike, si dhe mbrojtjes së pronësisë industriale e tregtare.

PJESA E DYTË

MBËRRITJA, PARAQITJA NE DOGAË DHE KONTROLI DOGANOR

KREU I

DISPOZITA TË PËRBASHKËTA

Neni 11

Kalimi i mallrave

Kalimi i mallrave në kufirin e Republikës së Shqipërisë bëhet sipas dispozitave të këtij kodi dhe akteve të tjera nënligjore.

Neni 12

Vendet e kalimit të mallrave e udhëtarëve

Mallrat dhe udhëtarët kalojnë territorin doganor të Republikës së Shqipërisë vetëm në vendet ku ka shërbim doganor.

Neni 13

Deklarimi

Në rastet e kalimit të mallrave nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, pronari i tyre, personat që i kanë në dorëzim ose përfaqësuesit e tyre, detyrohen të deklarojnë me shkrim mallrat në një formular të miratuar nga ministri i Financave dhe i Ekonomisë.

Neni 14

Ngarkimi, shkarkimi dhe transportimi i mallrave

Çdo veprim doganor kryhet në zonat doganore. Ngarkimi, shkarkimi dhe transportimi i mallrave në zonat doganore të Republikës së Shqipërisë nuk kryhet pa lejen e organeve doganore.

Ky ndalim nuk përshin shkarkimin dhe ngarkimin e pajisjeve ngarkuese e shkarkuese, të cilat shërbejnë për ruajtjen nga dëmtimi ose sigurimin e mallrave që janë në rrezik.

Neni 15

Kontrolli doganor i mjeteve të transportit dhe i mallrave

Kontrollet doganore që ushtrohen mbi mjetet e transportit dhe mallrat, si në kohën e kalimit të kufirit, ashtu edhe brenda territorit doganor, kryhen në prani të pronarit, përfaqësuesit ose drejtuesit të mjetit të transportit.

Neni 16

Kontrolli doganor ndaj personave

1. Për parandalimin dhe zbulimin e shkeljeve doganore, të përcaktuara në këtë kod, organet doganore ushtrojnë kontroll ndaj personave që kalojnë kufirin ose që qarkullojnë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, si dhe mallrave që ata transportojnë.
2. Doganierët ushtrojnë kontroll fizik ndaj personave, sipas dispozitave të caktuara nga ky kod.
3. Përjashtimet nga kontrolli doganor fizik caktohen me dispozita të veçanta ligjore.

Neni 17

Shkarkimi i mallrave në rrethana të jashtëzakonshme

Kur një mjet transporti ujor, ajror a tokësor nuk mund të arrijë në zonën doganore, për shkak të një defekti ose të arsyeve të tjera të pashmangshme (forcë madhore), lejohet shkarkimi jashtë zonës doganore.

Autoritetet lokale ose shërbimet doganore më të afërta nga vendi i shkarkimit lajmërohen sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 48 orë nga koha e shkarkimit.

Neni 18

Mallrat e gjetura ose të braktisura

1. Për mallrat e gjetura ose të braktisura në zonat doganore a përgjatë brezit kufitar dhe ato të shpëtuar nga mbytja e anijeve dhe sendet e nxjerra në breg, të çdo natyre, quhen të huaja dhe dorëzohen në organet doganore nga personi drejtpërdrejt ose nëpërmjet organeve të tjera lokale.
2. Këto mallra kalojnë në pronësi të shtetit, nëse për to nuk vërtetohet pronësia brenda 3 muajve nga data e njoftimit për gjetjen e tyre.
3. Këto mallra administrohen nga organet doganore sipas kritereve e mënyrës, të përcaktuara në udhëzimin e ministrit të Financave e të Ekonomisë.

Neni 19

Lundrimi në drejtim dhe bregëzimi në zonat doganore

Mjetet e transportit ujor, që hyjnë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, janë të detyruara të lundrojnë në drejtimet e përcaktuara me dispozita të veçanta që rregullojnë lundrimin në ujrat territoriale të vendit tonë, si dhe bregëzohen në vendet ku ka zona doganore.

Kur organet përkatëse që drejtojnë lundrimin në ujrat tona, bregëzojnë ose nisin mjetet ujore, në vendet ku nuk ka zona doganore, detyrohen të lajmërojnë organin doganor që e ka në kompetencë 48 orë përpara mbërritjes ose nisjes.

Neni 20

Kontrolli doganor në aeroporte

Në aeroportet ku janë vendosur organet doganore, doganierët kryejnë të gjitha veprimet doganore në kompetencë të tyre ndaj të gjitha mjeteve të transportit ajror, ekuipazhit të tyre, personave të pranishëm në bordet e tyre si dhe të gjitha mallrave që ato transportojnë në mbërritje, në nisje dhe gjatë qëndrimit të tyre.

Neni 21

Kontrolli doganor jashtë zonave doganore ujore, tokësore e ajrore

Kur një mjet transporti ajror, ujor e tokësor nuk kalon nëpër një zonë doganore gjatë importit ose eksportit, këto veprime i nënshtrohen një leje që lëshohet nga organet doganore. Kërkesa bëhet 48 orë para kryerjes së veprimeve.

KREU II
PARAQITJA E MALLRAVE NË DOGANË

I. IMPORTIMI
A. ME RRUGË UJORE

Neni 22

Dokumentet që mbahen në bordin e anijeve

1. Mallrat që vijnë në rrugë ujore, shkruhen në manifest ose në listat e përgjithshme të ngarkesës së anijes.
2. Ky dokument firmoset nga kapiteni i anijes, i cili cilëson llojin dhe numrin e kolive, markat e numrat e tyre, natyrën e mallrave dhe vendet e shkarkimit.
3. Ndalohet paraqitja në manifest e disa kolive të veçanta si një e vetme, sido që të paraqitet mënyra e bashkimit të tyre.
4. Mallrat e ndaluara paraqiten në manifest sipas emërimit të tyre të vërtetë, natyrës dhe llojit.

Neni 23

E drejta e kontrollit doganor në mjetet lundruese

Kapiteni i mjetit lundrues që mbërrin në ujërat territoriale të Republikës së Shqipërisë detyrohet:

1. T'u paraqesë menjëherë organeve doganore origjinalin e manifestit të ngarkesës doganierëve që ushtrojnë kontroll në bord.
2. T'u japë doganierëve një kopje të manifestit dhe të dokumenteve të tjera shoqëruese të mallit.

Neni 24

Kontrolli në anijet luftarake

Komandantët e anijeve të flotës luftarake detare plotësojnë në hyrje të gjitha formalitetet, të cilave u detyrohen kapitenët e anijeve tregtare.

Mënyrat e kontrollit doganor të anijeve luftarake kombëtare e të huaja përcaktohen më udhëzim të përbashkët të ministrit të Financave e të Ekonomisë dhe të ministrit të Mbrojtjes.

Neni 25

Detyrimet e kapitenit

1. Me hyrjen në port të anijes, kapiteni u paraqet doganierëve ditarin e bordit.
2. Brenda 24 orëve nga çasti i mbërritjes së anijes në port kapiteni deklaron në zonën doganore:
 - a) Nëpërmjet një deklarte përmbledhëse me shkrim:
 - manifestin e ngarkesës dhe, në rast nevojë, përkthimin e saktë të tij.
 - listën e mallrave të furnizimit në anije dhe listën e mallrave që i përkasin ekuipazhit.
 - b) Policëngarkesat ose konosamentet, aktet e kombësisë dhe të gjitha dokumentet e tjera që kërkohen nga organet doganore për zbatimin e procedurave doganore.Deklarata përmbledhëse paraqitet edhe kur anijet janë në radë.
Afati 24-orësh i përcaktuar më lart, nuk zbatohet për ditët e diela dhe ditët e pushimeve të festave.

Neni 26

Shkarkimi i anijeve

1. Anijet shkarkohen vetëm brenda portit, ku janë vendosur zonat doganore.
2. Asnjë mall nuk shkarkohet a transbordohet pa leje me shkrim të doganierëve dhe pa praninë

e tyre. Shkarkimi dhe transbordimi i mallrave kryhet gjatë orëve dhe sipas kushteve të caktuara nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave.

B. ME RRUGË AJRORE

Neni 27

Detyrimet e përgjithshme

1. Mjetet ajrore që kryejnë fluturime ndërkombëtare për të kaluar kufirin veprojnë sipas dispozitave të ligjit "Për kufirin shtetëror të Republikës së Shqipërisë".
2. Ato ulen vetëm në aeroportet, ku janë vendosur zonat doganore.

Neni 28

Dokumentet që mbahen në bordin e mjeteve të transportit ajror

Mallrat që transportohen me mjetet ajrore, pasqyrohen në manifest, i cili firmoset nga komandanti i mjetit. Ky dokument plotësohet sipas të njëjtave kushte, të caktuara në nenin 23 të këtij kodi, për mjetet ujore.

Neni 29

Detyrimet e komandantit të mjetit ajror

1. Komandanti i mjetit ajror, me mbërritjen e tij në aeroport, u paraqet manifestin doganierëve.
2. Ai ua dorëzon këtë dokument në formën e deklaratës përmbledhëse organeve doganore të aeroportit dhe, në rast nevojë, edhe përkthimin autentik të saj, me mbërritjen e tij në aeroport. Nëse mjeti ajror mbërrin në aeroport para hapjes së doganës, komandanti i dorëzon manifestin menjëherë me hapjen e doganës.

Neni 30

Shkarkimi i mjeteve ajrore

Rregullat e caktuara në nenin 26, paragrafi i dytë i këtij kodi, për shkarkimet e transbordimet, zbatohen edhe për transportet e kryera në rrugë ajrore.

C. ME RRUGË TOKËSORE

Neni 31

Detyrimet e përgjithshme

1. Të gjitha mallrat e importuara nga kufijtë tokësorë të Republikës së Shqipërisë, paraqiten menjëherë në zonën më të afërt doganore nëpërmjet rrugës më të drejtpërdrejtë.
2. Ato nuk kalohen nëpër shtëpi ose ndërtesa të tjera, pa u paraqitur në zonën doganore.
3. Rrugët e kalimit drejtpërdrejt nga pika e kalimit kufitar në zyrën e doganës dhe orët e shërbimit doganor caktohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave.

Neni 32

Detyrimet e drejtuesve të mjeteve

1. Çdo drejtues mjeti që transporton mallra, sapo mbërrin në zonën doganore, i dorëzon doganës si deklaratë përmbledhëse një dokument të transportit rrugor (CMR, CARNET TIR), ku pasqyrohen mallrat që ai transporton.
2. Mallrat e ndaluara paraqiten në dokumente me emërtimin e tyre të vërtetë, natyrën dhe llojin.
3. Mallrat që mbërrijnë pas mbylljes së shërbimit doganor, lihen në anekset e zonës doganore

deri në momentin e hapjes së saj. Në këto raste deklarata përmbledhëse dhe dokumentet e tjera paraqiten sapo të fillojë shërbimi doganor.

Neni 33

Magazinat dhe zonat e zhdoganimit

1. Mallrat e paraqitura në doganë në kushtet e përcaktuara në nenet 22 deri 32 të këtij kodi, qëndrojnë në magazina ose vende zhdoganimi, sipas mënyrave të caktuara më poshtë, vetëm nëse për to është caktuar një regjim i tillë doganor.

2. Krijimi i magazinave dhe i vendeve të zhdoganimit caktohet me lejen e lëshuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, i cili, mbi bazën e kërkesës së personave të interesuar, miraton vendin, ndërtimin dhe rregullimin e tyre.

3. Leja që përcaktohet në pikën 2 të këtij ligji, cakton kushtet nga të cilat varet funksionimi i magazinave e vendeve të zhdoganimit, si dhe fikson detyrimet e përgjegjësinë e personave që i shfrytëzojnë ato.

4. Lejimi i mallrave në magazinat ose vendet e zhdoganimit kushtëzohet nga depot, deklarata përmbledhëse e personit të interesuar ose nga një dokument i plotë që zëvendëson deklaratën përmbledhëse.

Ky lejim ka për qëllim të vërë mallrat në përgjegjësinë e shfrytëzuesit kundrejt organeve doganore.

5. Koha maksimale e qëndrimit të mallrave në magazinat ose vendet e zhdoganimit caktohet me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave.

Pas përfundimit të afatit të parashikuar, mallrat përbëjnë objektin e një deklarate tjetër në doganë dhe i nënshtrohen një regjimi doganor përfundimtar.

II. EKSPORTIMI

Neni 34

Paraqitja e mallrave që eksportohen

1. Mallrat e caktuara për eksport paraqiten në një zonë doganore ose në vendet e caktuara të shërbimit doganor.

2. Në kufijtë tokësorë transportuesve u ndalohet t'i shmangen kontrollit dhe zonave doganore.

III. MALLRAT E VEÇANTË QË LIVROHEN ME KABLLO OSE TUBACIONE

Neni 35

Për gazin, produktet e naftës dhe energjinë elektrike

1. Mallrat kombëtare dhe të huaja që livrohen në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë brenda tubacioneve dhe nëpërmjet linjave elektrike, quhen të eksportuara, të importuara ose të tranzituara, në momentin që vërtetohet se lëshohen në këto tubacione ose linja për livrim të drejtpërdrejtë.

2. Për gazin dhe produktet e naftës kontrollet ushtrohen në depot e grumbullimit me ndihmën e aparateve matëse të duhura e të miratuara nga organet doganore.

3. Mënyrat e kontrollit të livrimit të energjisë elektrike përcaktohen me urdhër të ministrit të Financave dhe të Ekonomisë.

PJESA III

VEPRIMET E ZHDOGANIMIT

KREU I

DEKLARATA E DETAJUAR

Neni 36

Karakteri i detyrueshëm i deklaratës së detajuar

Të gjitha mallrat e importuara a të eksportuara përbëjnë objektin e një deklarate të detajuar, duke iu nënshtruar një regjimi doganor, i cili mund të jetë për përdorim të brendshëm në vend, eksportim ose një regjim të ndërmjetëm.

Neni 37

Depozitimi i deklaratës së detajuar

1. Deklarata e detajuar depozitohet në një zyrë doganore për të filluar veprimet doganore të parashikuara.

2. Deklarata e drejtuar depozitohet përpara përfundimit të afatit të caktuar me urdhër nga ministri i Financave dhe i Ekonomisë, që fillon me mbërritjen e mallrave në doganë, ose vendet e caktuara nga shërbimi doganor.

Neni 38

Personat e autorizuar për deklarimin e mallrave në detaje

Mallrat e importuara a eksportuara deklarohen në detaje nga pronari i tyre ose nëndorësi.

Këta të fundit i japin të drejta të plota një përfaqësuesi ose agjenti doganor, të kryejë formalitetet në emër të tyre. Ministri i Financave dhe i Ekonomisë përcakton me udhëzim të veçantë statusin e agjentit doganor dhe të gjitha procedurat e nevojshme në lidhje me të.

Formulimet e bëra në deklaratën doganore ngarkojnë me përgjegjësi nënshkruesin.

Neni 39

Forma dhe përmbajtja e deklaratave të detajuara

1. Deklaratat e detajuara bëhen me shkrim.

2. Ato përmbajnë të gjitha të dhënat e nevojshme për zbatimin e dispozitave doganore.

3. Ato japin të dhëna për përpilimin e statistikave.

4. Ato firmosen nga personi që i përpilon.

5. Ministri i Financave dhe i Ekonomisë cakton formën e deklaratave, të dhënat që ato përmbajnë dhe dokumentet që i shoqërojnë. Ai cakton, në raste të veçanta, zëvendësimin e deklaratës me shkrim me një deklaratë të thjeshtësuar me gojë, veçanërisht për udhëtarët.

Neni 40

Lehtësitë e ofruara për personat që përpilojnë deklaratat e detajuara

Personat e autorizuar për depozitimin e deklaratave të detajuara, kur ato nuk përmbajnë të gjitha elementet, autorizohen të saktësojnë mallrat para deklarimit, duke marrë mostra. Këto veprime kryhen nën mbikëqyrjen e shërbimit doganor.

Neni 41

Pranimi dhe regjistrimi i deklaratave të detajuara

1. Deklaratat e detajuara të pranuar nga doganierët regjistrohen menjëherë prej tyre.

2. Quhen të papranueshme deklaratat jo të rregullta në formë ose që nuk shoqërohen nga dokumente të tjera, përpilimi i të cilave është i detyrueshëm.

Neni 42

Korrigjimi dhe anulimi i deklaratave të detajuara

Personi që ka depozituar një deklaratë të detajuar, në kushte të caktuara mund ta korrigjojë ose anulojë atë.

Ministri i Financave dhe i Ekonomisë cakton me urdhër kushtet dhe mënyrat e korrigjimit e të anulimit të deklaratës së detajuar.

KREU II VERIFIKIMI I MALLRAVE

Neni 43

Kushtet e kryerjes së verifikimit të mallrave

1. Pas regjistrimit të deklaratës së detajuar, shërbimi doganor kryen, nëse e gjykon të nevojshme, verifikimin e të gjitha ose të një pjese të mallrave të deklaruar.

Verifikimi i mallrave të deklaruar në zonat doganore kryhet vetëm në magazinat doganore, ose në vendet e caktuara për këtë qëllim nga organet doganore. Transporti i mallrave për në vendet e verifikimit, shpaketimi, paketimi dhe të gjitha veprimet e nevojshme për kryerjen e verifikimit, kryhen me shpenzimet dhe nën përgjegjësinë e personit që ka depozituar deklaratën. Të njëjtat mallra përbëjnë objektin e kontroleve doganore të njëpasnjëshme po aq të nevojshme.

2. Verifikimi i mallrave kryhet në prani të personit që ka depozituar deklaratën. Ai kryhet jo më vonë se pesë ditë nga dita e depozitimit të deklaratës në detaje, përveç rasteve të veçanta të caktuara nga ministri i Financave dhe i Ekonomisë.

3. Organet doganore marrin mostra, të lejuara nga pronari, për qëllim analize ose përcaktimit të mëtejshëm. Në rast të kundërt organet doganore marrin masa të tjera identifikimi.

Neni 44

Zbatimi i detyrimeve në funksion të rezultateve të verifikimit

1. Detyrimet, taksat dhe masat e tjera doganore, zbatohen sipas rezultateve të verifikimit.

2. Kur shërbimi doganor nuk kryen verifikimin e mallrave të deklaruar, detyrimet, taksat dhe masat e tjera doganore zbatohen sipas të dhënave të deklaratës së detajuar.

Neni 45

Ankimi kundër përfundimeve të kontroleve doganore

Pronari i mallrave ose përfaqësuesi i tij mund të kundërshtojë përfundimet e verifikimit. Në rastet e kontrollit të pjesshëm ata mund të kërkojnë verifikimin e plotë të të dhënave të deklaratës ndaj të cilës bëhet kundërshtimi.

Kjo kërkesë paraqitet në organet doganore gjatë kryerjes së verifikimit.

Një kundërshtim i tillë mund të paraqitet nga të njëjtët persona te Drejtori i Përgjithshëm i Doganave brenda 5 ditëve nga njoftimi i përfundimit të kontrollit.

Drejtori i Përgjithshëm i Doganave u përgjigjet ankesave brenda 30 ditëve nga data e marrjes së ankesës.

KREU III ZHDOGANIMI I DËRGESAVE POSTARE NDËRKOMBËTARE

Neni 46

Dorëzimi i dërgesave ndërkombëtare postare dhe i kolipostave

Dorëzimi i dërgesave ndërkombëtare postare dhe i kolipostave u bëhet pritësve të tyre nga punonjësit e postës, në prani ose mbi bazën e lejes me shkrim të doganierit.

Për të gjitha mangësitë që vërtetohen, si dëmtime, shenja hapjeje, diferenca në peshë, në dërgesat ndërkombëtare postare e kolipostare, përgjigjen organet postare.

Neni 47

Kontrolli doganor i dërgesave ndërkombëtare postare dhe i kolipostave

Kontrolli doganor i dërgesave ndërkombëtare dhe i kolipostave bëhet në mjediset e shërbimit postar, në prani të pritësve, nisësve a të punonjësve të caktuar të administratës së postës.

Caktimi i mjediseve të dorëzimit të dërgesave ndërkombëtare postare e kolipostare bëhet në marrëveshje nga Drejtoria e Përgjithshme e PTT-së dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Neni 48

Kriteret e zhdoganimit të dërgesave ndërkombëtare postare e kolipostare

Kriteret e zhdoganimit të dërgesave ndërkombëtare postare e kolipostare caktohen nga ministri i Financave dhe i Ekonomisë.

KREU IV

REGJIMET E MAGAZINIMIT DHE TË NDËRMJETME

Neni 49

Regjimet e ndërmjetme

Mallrat që nuk paraqiten për konsum brenda vendit, vendosen nën një regjim të ndërmjetëm për zbatimin e detyrimeve e të taksave dhe, në raste nevojë të masave ndaluese.

Mënyrat e veçanta të funksionimit të këtyre regjimeve caktohen nga ministri i Financave dhe i Ekonomisë. Megjithatë ky i fundit mund t'ia kalojë kompetencat drejtorit të Përgjithshëm të Doganave.

Neni 50

Tranziti

Përveç regjimeve të tranzitit të parashikuara nga konventat ndërkombëtare, regjimi i tranzitit lejon, që mallrat e importuara të qarkullojnë deri në destinacionin e tyre, pa likuiduar detyrimet dhe taksat doganore.

Vendosja e mallrave nën këtë regjim kryhet në çastin e kalimit të kufirit shtetëror.

Ky regjim përfundon në çastin kur në destinacion mallrat paraqiten për konsum brenda vendit, ose vendosen nën një regjim tjetër doganor.

Regjimi i tranzitit mund të përdoret për veprimet e eksportit të mallrave.

Neni 51

Magazinat kufitare doganore

Magazinat kufitare doganore, në të cilat mallrat e importuara magazinohen përkohësisht, në pritje për t'u paraqitur për konsum brenda vendit ose për t'u rieksportuar, miratohen paraprakisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Magazinat kufitare doganore vendosen nën mbikëqyrjen e shërbimit doganor, që kryen ndaj tyre të gjitha kontrollet e nevojshme. Mallrat që vendosen në këto magazina, detyrohen të jenë në çdo çast të kontrollueshme nga shërbimi doganor.

Kohëzgjatja e qëndrimit të mallrave në këto magazina lejohet për jo më shumë se një vit.

Mallrat e vendosura në këto magazina, pas marrjes së autorizimit nga organet doganore, mund të bëhen objekt i të gjitha llojeve të trajtimeve të nevojshme për ruajtjen e tyre.

Regjimi i magazinave kufitare doganore përfundon me paraqitjen e mallrave për konsum brenda vendit ose vendosjen e tyre nën një regjim tjetër doganor. Kur organet doganore vërejnë zhdukjen e tyre, kjo konsiderohet si kalim për konsum brenda vendit.

Detyrimet e taksave doganore llogariten mbi vlerën e mallrave dhe përqindjen e tarifës doganore në fuqi në datën e paraqitjes së tyre për konsum brenda vendit ose në datën e konstatimit të zhdukjes së tyre.

Neni 52

Lejimi i përkohshëm

Mallrat e importuara përkohësisht sipas drejtimit të përdorimit të tyre në territorin doganor vendosen nën regjimin e lejimit të përkohshëm, duke pezulluar pagimin e detyrimeve e taksave pas lëshimit të autorizimit përkatës nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Gjatë qëndrimit të mallrave në këtë regjim ato vendosen nën mbikëqyrjen e organeve doganore dhe u paraqiten atyre me kërkesën e parë.

Ky regjim përfundon me rieksportimin e mallrave ose vendosjen e tyre nën një regjim tjetër doganor, me qëllim që të rieksporthen më vonë.

Nëse në autorizimin e lëshuar, në raste të veçanta, lejohet shprehimisht edhe kalimi i mallrave për konsum brenda vendit, detyrimet dhe taksat vendosen mbi vlerën e mallit sipas përqindjeve në fuqi në datën e vendosjes së këtyre mallrave nën këtë regjim.

Neni 53

Përpunimi aktiv

1. Kur përlijet nga kushtet ekonomike, lejohet vendosja nën regjimin e përpunimit aktiv për mallrat e importuara, me qëllim transformimin e tyre në territorin doganor, me kusht që produkti i përfituar të rieksporthet jashtë këtij territori.

Për mallrat e importuara nën këtë regjim, bëhet përjashtimi nga detyrimet e taksat doganore, qoftë edhe nëpërmjet rimbursimit të parave të paguara për importimin e tyre, në momentin e rieksportimit të produkteve të përfituara nga transformimi.

2. Gjatë zbatimit të këtij regjimi mallrat që përfitojnë nga ky regjim, janë nën mbikëqyrjen e organeve doganore, të cilave u paraqiten në çdo kohë me kërkesën e parë.

Ky regjim përfundon me rieksportimin e produkteve të përfituara. Nëse përjashtimisht është lejuar që këto produkte të paraqiten për konsum brenda vendit, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet dhe taksat, caktohen mbi vlerën e mallrave të importuara dhe sipas përqindjeve në fuqi, në datën e vendosjes në këtë regjim, në varësi nga sasia e mallrave të importuara, të transformuara faktikisht.

3. Kur për mallrat e vendosura nën këtë regjim janë paguar detyrimisht dhe taksat, këto detyrime e taksa rimbursohen në momentin e rieksportimit të produkteve të përfituara, në varësi nga sasia e mallrave të importuara, të transformuara faktikisht.

Neni 54

Regjimi i përjashtimit të mallrave të riimportuara

Mallrat e riimportuara në të njëjtën gjëndje, nga personat që i kanë eksportuar, përfitojnë përjashtimin nga taksat e importit.

Kur mallrat e eksportuara përkohësisht riimportohen pasi t'i jenë nënshtruar riparimit, transferimit ose përpunimit jashtë territorit doganor, detyrimet e taksat për importimin e tyre llogariten për diferencën ndërmjet vlerës së mallit të importuar dhe vlerës së mallit të eksportuar përkohësisht.

KREU V

PARAQITJA PËR KONSUM BRENDË VENDIT DUKE PAGUAR DETYRIMET E TAKSAT

Neni 55

Mallrat që u nënshtrohen detyrimeve doganore

Mallrat që importohen dhe disa mallra të veçanta që eksportohen nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, i nënshtrohen nxjerrjes së detyrimeve doganore, në bazë të të drejtave doganore, të caktuara në dispozitat e këtij kodi dhe të ligjit "Për tarifatat doganore".

Detyrimet doganore përbëhen nga:

- a) të drejtat e kufirit (taksat e importit dhe eksportit);
- b) të drejtat e monopolit shtetëror për produkte të veçanta;
- c) të drejtat e doganës për arkëtimin e tarifave të shërbimit doganor.

Ministri i Financave dhe i Ekonomisë cakton kufijtë në vlerë të mallrave të kaluara në territorin doganor nga udhëtarët sipas kushteve ekonomike të vendit, pa iu nënshtruar detyrimeve doganore.

Mënyra e vjeljes së detyrimeve doganore caktohet nga ministri i Financave dhe i Ekonomisë mbi bazën e dispozitave të këtij kodi.

Neni 56

Caktimi i tarifave doganore

Tarifa e detyrimeve doganore dhe elementet e nevojshme për llogaritjen e këtyre detyrimeve caktohen me ligj.

Neni 57

Përjashtimi nga taksat doganore i mallrave të importit dhe eksportit

Përjashtimi nga detyrimet dhe taksat kryhet mbi bazën e konventave ndërkombëtare si dhe me ligje të veçanta.

Neni 58

Mënyra për nxjerrjen e detyrimeve doganore

Detyrimet paguhen në çastin e pranimi të deklaratës doganore.

Deri në këtë çast tërësia e mallrave është e vendosur në magazina nën mbikëqyrjen e organeve doganore.

Një pjesë e mallrave lirohet për konsum pas kontrollit, me kusht që:

- të sigurohet detyrimi përkatës doganor;
- të sigurohet pagimi i këtyre detyrimeve me pjesën e mbetur të mallrave në magazinë.

Detyrimet doganore mund të paguhen pas paraqitjes për konsum brenda vendit të mallrave të importuara, në qoftë se jepen garanci financiare, sipas kushteve të caktuara me urdhër nga ministri i Financave dhe i Ekonomisë.

Neni 59

Nxjerrja e detyrimeve doganore

Urdhri i organeve doganore për detyrimet që rrjedhin në zbatimin e këtij kodi, është titull ekzekutiv.

Detyrimet doganore dhe çdo pagesë tjetër kur nuk paguhen brenda afateve të caktuara, nxirren sipas ligjit mbi nxjerrjen e të ardhurave shtetërore.

Me përfundimin e afatit maksimal të qëndrimit të mallrave:

- në magazina dhe në zonat e zhdoganimit;
- ose në një regjim doganor të ndërmjetëm, ato mund të shiten brenda tre muajve, pas paraqitjes për konsum brenda vendit nga blerësi që paguan edhe detyrimet.

Pas zbritjes së shpenzimeve të ruajtjes dhe magazinimit paratë derdhen në buxhetin e shtetit.

Neni 60

Për mallrat e prishura

Shkatërrimi ose prishja e përgjithshme a e pjesshme e mallrave konstatohet dhe merret parasysh nga organet doganore.

Neni 61

Likuidimet e parregullta

1. Nëse detyrimet doganore të likuiduara efektivisht janë më të larta ose më të ulëta nga sa duhen, diferencat përkatëse reklamohen nga organet doganore ose nga personi i interesuar në një afat prej tre vjetësh nga data e pagimit.

2. Edhe kur nuk kërkohen por këto konstatohen nga organet doganore ose financiare brenda afatit të sipërpërmendur, u kthehen personave të interesuar.

PJESA IV DISPOZITAT E KUNDËRVAJTJEVE DHE KONTRABANDËS

KREU I KUNDËRVAJTJET DHE KONTRABANDA

Neni 62

Kundërvajtjet

Përbëjnë kundërvajtje:

1. Zëvendësimi i mallrave në dogana.
2. Çdo veprim ose falsifikim i dokumenteve të kërkuara nga organet doganore, i cili nuk ka për qëllim shmangien nga kontrolli doganor ose mospagimin a zvogëlimin e pagimit të detyrimeve doganore, ose përfitimin e një privilegji të çfarëdoshëm lidhur me importin a eksportin.
3. Mosparaqitja ose ndryshimi i natyrës a llojit për mallrat e deklaruar për eksport të përkohshëm, midis mallrave faktikë dhe atyre të paraqitur në nisje.
4. Gjetja e mallrave që nuk taksohen dhe që janë të padeklaruara.
5. Kundërshtimi ose vonimi i doganierëve për të kryer detyrën.
6. Mosplotësimi në rregull i dokumenteve, ose plotësimi i tyre me korrigjime.
7. Mosrespektimi i afateve të përcaktuara për paraqitjen e mallrave në doganë, ose i çdo afati tjetër të përcaktuar në këtë kod.
8. Gjetja e diferencave më shumë ose më pak deri në 5 për qind të sasisë së mallit të vendosur në magazinë, që ndodhen nën mbikëqyrjen e doganës.

Neni 63

Kontrabanda

Me kontrabandë kuptohet:

1. Fshehja e mallrave, ndaj të cilave zbatohet taksa doganore, për t'iu shmangur kontrollit doganor.
2. Moskalimi në rrugën më të drejtpërdrejtë ndërmjet pikës së kalimit kufitar dhe zyrës doganore, ose kalimi nëpërmjet zyrave doganore jashtë kohës së punës.
3. Çdo veprim ose falsifikim, i cili ka për objekt shmangien e kontrollit doganor të mallrave, shmangien e ndalimit të mallrave nga organet doganore në hyrje a në dalje nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, ose zvogëlimin a mospagimin e detyrimeve doganore.
4. Importimi ose eksportimi i mallrave jashtë zonave doganore pa lejen e organeve doganore.
5. Importimi ose eksportimi i mallrave që ndalohen të futen a të dalin nga territori i Republikës së Shqipërisë.
6. Krijimi i diferencave më shumë ose më pak, mbi 5 për qind të sasisë së mallit të vendosur në magazinat që ndodhen nën mbikëqyrjen e doganës.
7. Mospërputhja ndërmjet deklaratës së depozituar dhe mallrave faktike.
8. Krijimi i mungesave të mallrave të importuara për qëllime rieksperti.
9. Blerja, shitja ose marrja a dhënia dhuratë e mallrave që dihet se janë mallra kontrabandë.

Neni 64

Për mallrat e ndaluara ose me taksa të larta

1. Të gjithë ata që mbajnë ose transportojnë mallra të ndaluara, të cilat caktohen me urdhër të veçantë të ministrit të Financave dhe të Ekonomisë, u paraqesin organeve doganore, me kërkesën e tyre të parë, të gjitha dokumentet që dëshmojnë se këto mallra importohen rregullisht brenda territorit doganor të Republikës së Shqipërisë. Këto dokumente janë fatura e blerjes, certifikata e fabrikimit dhe të gjitha dokumentet e tjera që shprehin të dhëna treguese për origjinën e mallit dhe për personat ose

shoqëritë e vendosura rregullisht.

2. Të njëjtat detyrime zbatohen edhe për mbajtësit ose transportuesit e mallrave, ndaj të cilave zbatohen taksa të larta. Mallrat ndaj të cilave quhet se zbatohen taksa të larta, caktohen me urdhër të ministrit të Financave dhe Ekonomisë.

3. Të gjithë ata që mbajnë, transportojnë, shesin ose këmbajnë mallrat e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, janë të detyruar të paraqesin në çdo kohë dokumentet e përcaktuara si më sipër, në një afat prej tre vjetësh nga çasti i marrjes në dorëzim të këtyre mallrave prej tyre, ose nga çasti i dorëzimit të dokumenteve të origjinës organeve doganore.

4. Nuk i nënshtrohen zbatimit të këtyre dispozitave mallrat, të cilat mbajtësit, transportuesit, shitësit ose këmbyesit dëshmojnë me dokumentet e tyre të shkruara se i kanë importuar, marrë ose blerë në territorin doganor para hyrjes në fuqi të këtyre dispozitave.

Neni 65

Procesverbali i doganës

1. Shkeljet e dispozitave doganore konstatohen nga doganierët që përpilojnë procesverbalin përkatës, sipas formave të caktuara me urdhër të ministrit të Financave dhe të Ekonomisë.

2. Procesverbalet doganore, të përpiluara nga një doganier, quhen të vlefshme deri në paraqitjen e provave të kundërta organeve doganore.

Procesverbalet doganore, të përpiluara nga dy a më shumë doganierë, quhen të vlefshme deri në regjistrimin e miratimit kundërshtimit me konstatime materiale të lidhura me to.

Neni 66

E drejta e kontrollit

Për kërkimin dhe gjetjen e provave të shkeljeve doganore të parashikuara në këtë kod, organet doganore, me autorizim të kryetarit të degës doganore ose drejtorit të Drejtorisë Rajonale a drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, mund të ushtrojnë kontrolle në çdo vend, kur ka të dhëna të mjaftueshme se aty gjenden dokumente a mallra që lidhen me këto shkelje, të cilat sekuestrohen.

Neni 67

E drejta e marrjes së informacionit

Në asnjë rast një administratë, një person juridik a fizik, nuk mund të pengojë doganierët për të marrë informacione që u duhen për të nxjerrë detyrimet dhe taksat doganore, të pajisur me leje nga ministri i Financave dhe i Ekonomisë, edhe nëse ky informacion përfshihet në sekretin profesional.

Duke pasur të drejta dhe cilësinë për të ushtruar edhe marrjen e informacionit të lartpërmendur, doganierët, detyrohen të ruajnë sekretin profesional.

Ministri i Financave dhe i Ekonomisë cakton mbajtësit që gëzojnë këto të drejta, dhe kufizimet e tyre.

Neni 68

E drejta e sekuestrimit

Shkeljet e dispozitave ligjore e nënligjore për doganat konstatohen nga një a më shumë punonjës të organeve doganore.

Organet doganore që konstatojnë shkelje doganore, e cila përbën kundërvajtje, kanë të drejtë të vendosin gjoba, dhe të sekuestrojnë një pjesë ose të gjithë sasinë e mallit, objekt i kundërvajtjes.

Kur shkelja është në rast kontrabandë, organet doganore sekuestrojnë të gjithë mallin objekt të kontrabandës dhe, kur është e mundur, edhe mjetet me të cilat ato janë kryer, si dhe të gjitha dokumentet që lidhen me këto shkelje, dhe ndalojnë të gjitha objektet e tjera për të siguruar zbatimin e dënimeve.

Neni 69

E drejta e ndalimit

1. Organet doganore kanë të drejtën e ndalimit të personave të cilët kryejnë shkelje që përbëjnë vepër penale.
2. Organet kompetente për fillimin e çështjes penale dhe prokurori lajmërohen menjëherë.
3. Koha e ndalimit nuk i kalon 24 orët, brenda të cilave organet kompetente detyrohen të marrin në dorëzim të ndaluarin. Koha e ndalimit prej 24-orësh llogaritet në afatin maksimal të ndalimit të parashikuar nga kodi i procedurës penale.
4. Të drejtat mbrojtëse të personave përcaktohen dhe zbatohen në bazë të legjislacionit përkatës të Republikës së Shqipërisë.

KREU II

SANKSIONET, SHPËRNDARJA E TË ARDHURAVE, GJOBA, PROCEDURAT E ANKIMIT

Neni 70

Sanksionet

1. Të gjitha rastet e kundërvajtjeve, të përcaktuara në nenin 62 të këtij Kodi, si dhe rastet e tjera të shkeljes së dispozitave ligjore e nënligjore, të cilat nuk përbëjnë kontrabandë, dënohen nga organet doganore me gjobë deri në 10 mijë lekë dhe me sekuestrimin e pjesshëm a të plotë të mallit. Ministri i Financave dhe i Ekonomisë cakton kriteret më të detajuara për masën e gjobës sipas llojit të kundërvajtjes dhe vlerës së mallrave kundërvajtje.
2. Të gjitha rastet e kontrabandës, kur kryhen për herë të parë dhe vlera është nën 5 mijë, dënohen nga organet doganore me gjobë deri në 10 mijë lekë dhe me konfiskimin e mallit e të objekteve kontrabandë.
Kur kontrabanda është e përsëritur, ose edhe kur kryhet për herë të parë, por me një vlerë mbi 5 mijë lekë, organet doganore ndalojnë personat përgjegjës dhe, mbi bazën e provave materiale, çështja u kalohet organeve kompetente për ndjekje penale.
3. Të gjitha mallrat e ndaluara a të konfiskuara mbahen nga organet doganore dhe trajtohen sipas dispozitave të këtij kodi. Gjithashtu të gjitha mallrat ose mjetet e kapura nga organet e tjera që futen në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë në rrugë të paligjshme, u dorëzohen organeve doganore.

Neni 71

Shpërndarja e të ardhurave nga gjobat dhe sekuestrimet

1. Pjesa që i kalon buxhetit të shtetit nga të ardhurat e gjobave e sekuestrimet në doganë, është e barabartë me 70 për qind të të ardhurave neto prej tyre.
2. Pjesa tjetër, prej 30 për qind, përdoret sipas udhëzimit të ministrit të Financave dhe të Ekonomisë që cakton përqindjet, të cilat u jepen:
 - a) Organeve doganore për shpenzime për nevojat e brendshme dhe për përmirësimin e kushteve të punës;
 - b) doganierëve për shpërblimin e konstatimit të shkeljeve;
 - c) Informuesve, të cilët, me të dhënat e tyre shërbimit doganor, kanë bërë të mundur konstatimin e shkeljes.

Neni 72

Procedura e ankimit

Ankimi kundër dënimit të dhënë ose për pretendim, bëhet nga personi i interesuar brenda 5 ditëve, duke filluar nga data e komunikimit të dënimit ose e lindjes së çdo pretendimi, te kryetari i degës së doganës kompetente, i cili duhet të përgjigjet me shkrim brenda 10 ditëve.

Kur personi i interesuar nuk është i një mendimi me vendimin ose me përgjigjen e kryetarit të degës së doganës brenda 5 ditëve mund të bëjë ankesë me shkrim te drejtori i Rajonale që ka në vartësi

kryetarin e degës së doganës, tek i cili është bërë ankim. Drejtori i Drejtorisë Rajonale përgjigjet me shkrim brenda 30 ditëve.

Kur personi i interesuar nuk është i një mendimi me vendimin e drejtorit të Përgjithshëm të Doganave, brenda 10 ditëve mund të bëjë ankesë në organet gjyqësore.

KREU III DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 73

Dekreti nr.4743, datë 30.9.1970, ndryshuar me dekretet nr.5126, datë 4.12.1973, nr.5337, datë 23.9.1975, nr.5412, datë 25.5.1976, nr.5843, datë 3.3.1979, nr.7216, datë 21.10.1988, neni 36 i ligjit nr.7407, datë 31.7.1990, si dhe dekreti i Presidentit nr.37, datë 30.9.1991, si dhe çdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me dispozitat e këtij Kodi shfuqizohen.

Neni 74

Ky Kod hyn në fuqi 15 ditë pas shpalljes.

Shpallur me dekretin nr.298, datë 17.9.1992 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Sali Berisha.